



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPKI</u>	Br. Prot. <u>03-02/4445/16</u>
Dep. _____	Prot No. _____
Nr. i faq. _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>25.11.2016</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3353/16, për znj. Ilirjana Raça – Bunjaku, Drejtoreshë e Klinikës së Pulmologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se ajo ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3353/16, për znj. Ilirjana Raça – Bunjaku - Drejtoreshë e Klinikës së Pulmologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtarja e lartë znj. Raça - Bunjaku, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik në QKUK dhe person i autorizuar në biznesin privat “Jeta”.

Fillimisht ajo është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, ajo është takuar nga zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Në takim, znj. Raça – Bunjaku, ka deklaruar se vullnetarisht e ka mbylluar biznesin, që e ka dëshmuar edhe me shkresë zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

(DPKI 03 – 02/4403/16) me të cilën vërtetohet se ajo, vullnetarisht ka mbyllur biznesin privat “Jeta”. Me këtë ajo ka shmangur konfliktin e interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

